



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT

V E N D I M

Nr. 16, datë 08.11.2019

PËR

**MIRATIMIN E LEJES SË NDËRTIMIT PËR OBJEKTIN: “ZGJERIM I RRJETIT TË
KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE TË OPERATORIT VODAFONE ALBANIA
NËPËRMJET SHTIMIT TË ANTENAVE PËR 3 STACIONE BAZË TË EMËRTUARA:
1246 GERMENJL, 1283 ELBASANI STR DHE 1285 FIERI 2 RELOC, ME
VENDNDODHJE NË BASHKITË KOLONJË, TIRANË DHE FIER”**

Në mbështetje të neneve 27 dhe 28 të Ligjit Nr. 107, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar, VKM-së Nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar, si dhe VKM-së Nr.519, datë 20.09.2017 “Për përcaktimin e përbërjes së Këshillit Kombëtar të Territorit”, i ndryshuar, me propozim të shoqërisë “Vodafone Albania” sh.a, Këshilli Kombëtar i Territorit,

VENDOSI:

1. Miratimin me kusht të Lejes së Ndërtimit për objektin: “Zgjerim i rrjetit të komunikimeve elektronike të operatorit Vodafone Albania nëpërmjet shtimit të antenave për 3 stacione bazë të emërtuara: 1246 Germenji, 1283 Elbasani Str dhe 1285 Fieri 2 Reloc, me vendndodhje në Bashkitë Kolonjë, Tiranë dhe Fier”, me zhvillues shoqërinë “Vodafone Albania” sh.a.
2. Harta e Planvendosjes së Strukturave bashkëlidhet si pjesë përbërëse e këtij vendimi.
3. Dokumentet i Lejes së Ndërtimit i jepen subjektit zhvillues veçmas për secilin prej 3 stacioneve bazë, vetëm pas plotësimit të kushteve të poshtëshënuara:
 - a. Për stacionin “**1246 Germenji**”:
 - pagesës së taksës së ndikimit në infrastrukturë për llogari të Bashkisë Kolonjë.
 - b. Për stacionin “**1283 Elbasani Str**”:
 - pagesës së taksës së ndikimit në infrastrukturë për llogari të Bashkisë Tiranë.
 - c. Për stacionin “**1285 Fieri 2 Reloc**”:
 - regjistrimit të Lejes së Legalizimit pranë Drejtorisë Vendore të ASHK Fier;
 - pagesës së taksës së ndikimit në infrastrukturë për llogari të Bashkisë Fier.



4. Ngarkohet Agjencia e Zhvillimit të Territorit në bashkëpunim me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, për zbatimin e këtij vendimi.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

EDI RAMA



MINISTËR I LINJËS

MINISTËR I INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË

BELINDA BALLUKU




A circular official stamp in blue ink. The outer ring contains the text "REPUBLICA SHQIPERISE" at the top, "MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË" on the sides, and "TIRAN" at the bottom. In the center is the coat of arms of Albania, featuring a double-headed eagle.

ANËTAR / SEKRETAR I KKT

DREJTOR I AGJENCISË SË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT

LEDIA TOTA



A circular official stamp in blue ink. The outer ring contains the text "REPUBLICA SHQIPERISE" at the top, "AGJENCIA E ZHVILLIMIT TË TERRITORIT" on the sides, and "MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË" at the bottom. In the center is the coat of arms of Albania, featuring a double-headed eagle.